

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Në fakt, sot deputetët e opozitës kanë bërë shumë pyetje të përsëritura, për të cilat kanë marrë përgjigje si në komisionet respektive për dhënie mendimi, ashtu edhe në Komisionin përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese. Unë do të grupoj tri shqetësimet e opozitës, që, në fakt, janë duke helmuar opinionin publik me një objektiv të vetëm: fshehjen e shqetësimit kryesor, që këto projekte strategjike po i bën qeverisja socialiste dhe nuk po i bën ajo. Së pari, është bluf shumë i madh politik akuza se qeveria po grabit pasurinë publike për interesat e një pale private. Në marrëveshje, e cila është publike edhe për anëtarët e komisioneve respektive, por edhe për të tjerët, është shumë e qartë se kalatat 66 mijë metra katrorë, baseni i portit dhe kanali hyrës i portit nuk ndryshojnë asnjëherë.

Nga 80 hektarë zonë zhvillimore, 20% e tyre transferohen në hapësira të gjelbra për qytetin e Durrësit. Marina e Durrësit dhe asetet përkatëse në përfundim të ndërtimit të saj do të jenë në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, pra të shtetit. Ndërtimi i pallateve dhe hoteleve, që aq shumë i trumbetoni me foto apo me letra, janë pjesë e një menaxhimi të përbashkët, ku shteti ka 33% të aksioneve, prej të cilit do të përfitojë jo vetëm dividendin, që ju e trumbetoni me të madhe, por do të ketë edhe shumë përfitime të tjera, përtej përfitimeve fiskale nga punësimi, mbi të gjitha me transformimin e një zone industriale në një zonë thellësisht qytetare, turistike dhe në një portë hyrëse shumë të rëndësishme për një qytet të rëndësishëm dhe historik.

Durrësi ka një histori 3000-vjeçare dhe jeta e qytetit ndër shekuj lidhet me portin. Është shumë e rëndësishme ta përmendim këtë fakt. Shumë transformime ndër shekuj kanë ndodhur në këtë qytet. Rruga Egnatia, që fillonte nga Durrësi, e ktheu qytetin në limanin më të rëndësishëm në brigjet e Mesdheut Lindor. Zhvendosja e portit të Durrësit në zonën që meriton të quhet port tregtar, aty ku edhe ndërlihdja jo vetëm me infrastrukturën rrugore, por edhe me atë hekurudhore, e bën atë një port të denjë tregtar dhe një portë hyrëse për të gjithë rajonin, për t'u lidhur më lehtë, më mirë dhe me kosto optimale.

Qyteti i Durrësit, me lashtësinë e tij, me vlerat e padiskutueshme të antikitetit, me Amfiteatrin, që shpresoj shumë shpejt, edhe me planet që ka Ministria e Kulturës, të marrë frymë dhe të dalë në dritë jo vetëm për ne, që krenohemi dhe e dimë se çfarë historie ka, por për të gjithë ata që do të vijnë dhe do

ta vizitojnë këtë qytet, duke e aksesuar atë këndshëm, do të kthehet, siç e thashë, në krenarinë e Shqipërisë për sa i përket turizmit elitär. Së dyti, përfitimi financiar. Opozita flet për dividendin, që do ta marrim në shumë vite dhe që është shumë i vogël, por harron përfitimet fiskale. Nuk po flas këtu vetëm për punësimin e 12 mijë njerëzve, por po flas për të gjitha përfitimet ndër vite, të cilat ndahen në 2 faza: në fazën e parë të gjitha taksat, tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë gati 315 milionë euro, dhe në fazën dytë janë 760 milionë euro.

Pra, në total janë mbi 1 miliard euro përfitime nga të gjitha këto tatime. Për të mos lënë pa përmendur impaktin indirekt, ku kontraktuesi dhe furnitori do të kenë, gjithashtu, përfitime nga zhvillimi i investimit, po ashtu furnizuesit e hoteleve, furnizuesit e utiliteteve, furnizuesit e restoranteve, bareve dhe restoranteve të jahteve. Për të folur pak për këtë të fundit (unë nuk jam teknike jahtesh dhe nuk besoj se ka ndonjë këtu që arrin të flasë për jahtet dhe për kapacitetet e tyre), mendoj se të gjithë ne, përpara se të themi se 280 vende ankorimi jahtesh të vogla, të mesme dhe të mëdha, super jahte, janë apo jo përfaqësimi i një marine të vogël, të madhe apo të mesme, duhet të pyesim ata që kemi gjeturë poshtë dhe komshinj lart, të paktën për të parë dhe për të marrë një referencë se çfarë e bën të rëndësishëm një port marinë.

Sigurisht, ata që e njohin mirë këtë fushë dhe kanë eksperiencë flasin për aftësi përpunimi të pasagjerëve dhe gjatësi jahti. Në relacion është shumë e theksuar që numri nuk është i vetmi kriter relevant për të përcaktuar madhësinë dhe rëndësinë e marinës, por gjatësia e jahteve që do të ankorohen dhe përpunimi i pasagjerëve do të jenë njëkohësisht më të rëndësishme si kriteret për të përcaktuar rëndësinë e këtij porti dhe të kësaj marine në aspektin turistik, për shndërrimin që do të ketë Durrësi dhe jo vetëm. Me këtë shndërrim që do t'i bëhet portit të Durrësit do të përfitojnë Tirana, Shkodra, Përmeti, Korça dhe Vlora, edhe pse kjo e fundit ka portet e saj tregtare dhe turistike, sepse do të jetë një nga portat kryesore jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin.

Nga ky port do të përfitojnë bizneset shqiptare, të cilat sot janë në qytete, por mbi të gjitha do të përfitojnë ato që janë në zonat rurale, me vendosjen në punë të të gjitha kapaciteteve të tyre për të bërë krenarë jo vetëm veten e tyre me produktin "Made in Albania", "Prodhuar në Shqipëri", por të gjithëve ne. Në një fakt nuk kemi se si të ndahemi, që të gjithë duhet të jemi krenarë për atë që është aseti ynë kryesor: mikpritja. Këtu nuk ndahemi, siç e thashë, as në demokratë, as në socialistë pasi përpunimi i të gjitha kapaciteteve shqiptare, i burimeve natyrore, i produkteve shqiptare, nuk krahasohen kurrë me mikpritjen shqiptare, që nëse do të flisni, sikurse ne të gjithë flasim me miq, shokë dhe personat që na vizitojnë, ata mahnitën nga zhvillimi i Shqipërisë në vitet e fundit.

Së fundi, dy fjalë për investitorin e huaj, që është shqetësimi i tretë kryesor juaji. Çfarë nuk keni folur në këto muaj të këtij viti, të paktën, për të gjitha iniciativat për ta bërë Shqipërinë më të bukur jo vetëm për ne, por edhe për të huajt. Folët për projektin e Butrintit. Ina mungon aktualisht, por në komision ju përplasët edhe mikrofonat në shenjë urrejtjeje për atë që do të ndodhte, sepse, sipas jush, ishte e pamundur ta bënte Fondi Amerikan i Zhvillimit. “Skavica nuk u duhet shqiptarëve. Nuk mund të bëhen investime historike në Shqipëri”. I kthehem sërish argumentit se është vetëm një përbaltje me objektivin dhe bezdinë që Shqipërinë po e ndryshon qeverisja socialiste me projekte strategjike dhe shumë të rëndësishme.

Të gjitha kompanitë e përmendura që janë të lidhura, janë publike, po ashtu, i janë nënshtruar ligjit dhe procedurave të kontrollit të institucioneve shqiptare. Çdo akuzë për lidhjet e kësaj marrëveshjeje me entitete offshore është fund e krye abuzive, sepse marrëdhënia e shtetit do të realizohet me subjekte të së drejtës shqiptare, që janë lidhur me entitete të të drejtave të vendeve të tjera, ku përfituesit fundorë janë qartësisht të identifikuar dhe nuk u përkasin subjekteve të sanksionuara nga organizma ndërkombëtarë. Sipas konfirmimit nga investitori privat apo entitete të lidhura me të nuk kanë asnjë transaksion financiar me personat që aludon opozita.

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Nuk besoj se ka njeri sot që, kur e krahason Shqipërinë me të paktën 10 vjet më parë, nuk ndihet i kënaqur, nuk ndihet në një vend më të mirë se dje. E ardhmja do të jetë akoma më e mirë. Infrastruktura, si ajo rrugore, portuale, edhe ajo hekurudhore nuk do ta bëjnë jetën e shqiptarëve më të mirë në aspektin e aksesit të lehtë, por do ta bëjnë në ekonomi. Mbi të gjitha, ky investim strategjik e vendos Shqipërinë në një hartë ndërkombëtare si asnjëherë më parë, për të cilën asnjë nga ne, në secilën anë të ulemi, nuk mund të jemi pishman për ta votuar, përkundrazi, duhet të jemi krenarë. Faleminderit!